



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSh. nr. 612/2022**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik (OE) "ALBI COMPANY" sh.p.k. me seli në Rahovec për aktivitetin e prokurimit me titull "Rigjenerimi i rrugësve Mehmet kaqurri (Rruga model ) Prishtinë" me numër të prokurimit:616-22-11110-5-2-1 Nr. të brendshëm: 616 22 169 521, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 22.11.2022, mori këtë:

**VENDIM**

**Hedhet si e pa lejuar** ankesa e datës 03.11.2022 (protokoll 612/22) e OE "ALBI COMPANY" sh.p.k. me seli në Rahovec, për aktivitetin e prokurimit me titull "Rigjenerimi i rrugësve Mehmet kaqurri (Rruga model ) Prishtinë" me numër të prokurimit:616-22-11110-5-2-1 Nr. të brendshëm: 616 22 169 521, iniciuar nga (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë.

**I lejohet** autoritetit kontraktues – Kuvendit Komunal Prishtinë , që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rigjenerimi i rrugësve Mehmet kaqurri (Rruga model ) Prishtinë" me numër të prokurimit:616-22-11110-5-2-1 Nr. të brendshëm: 616 22 169 521, iniciuar nga (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankese tjetër .

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik

ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

#### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 03.11.2022, ka pranuar ankesë nga OE "ALBI COMPANY" sh.p.k. me seli në Rahovec, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rigjenerimi i rrugësve Mehmet kaqurri (Rruga model) Prishtinë" me numër të prokurimit: 616-22-11110-5-2-1 Nr. të brendshëm: 616 22 169 521, iniciuar nga (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 612/2022.

Për aktivitetin prokurimit të cekur si më lart autoriteti kontraktues me datën 12.10.2022, ka publikuar – Njoftim për kontratë, në bazë të këtij Njoftimi afati i fundit për dorëzimin ofertave ka qenë data 24.10.2022.

Me datën 23.10.2022, OE "ALBI COMPANY" sh.p.k. me seli në Rahovec, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 24.10.2022, AK merr vendim duke e hedhur si të jashtafatshme kërkesën e OE ankues.

#### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse afati i fundit për dorëzimin ofertave ka qenë data 24.10.2022, kurse kërkesën për rishqyrtim OE ankues e ka parashtruar me dt. 23.10.2022. Nga sqarimet e dhëna si më lart konstatohet se OE ankues ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim 1/një ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, e jo *Brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Ku paragrafi 3.1 i nenit 108/A i Ligjit për Prokurim Publik specifikon: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Dhe neni 4.1 pika (a) e Rregullave të Paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

- a) *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart Kryetarja konstaton se ankesa e parashtruar

në OSHP nga OE: "ALBI COMPANY" sh.p.k. me seli në Rahovec, e datës 03.10.2022 me numër të Protokollit 612/2022, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4.1 pika (a) e "Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së  
  
Vjosa Gradinaj Mexhuani

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK Kuvendi Komunal Prishtinës  
1x1 OE "ALBI COMPANY" shpk me seli në Rahovec  
1x1 Arhivës së OSHP-së  
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së